



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCËS
MINISTRI

1391
Nr. ... Prot.

Tiranë, më 29.02.2012

UDHËZIM

Nr. 4, datë 29.02.2012

PËR

**DISA NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR. 45, DATË 19. 12. 2011 "PËR GJENERIMIN
DHE DHËNIEN E NUMRAVE TË MATRIKULLIMIT"**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës dhe të neneve 47, të pikës 3 të nenit 58 të Ligjit nr. 9741, datë 21.05.2007 "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar,

UDHËZOJ:

I. Në Udhëzimin nr. 45, datë 19. 12. 2011 "Për gjenerimin dhe dhënie e numrave të matrikullimit", bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Pika 2 e udhëzimit ndryshon si më poshtë:

"2. Studentët e marrin numrin e matrikulimit (NIM) të përbërë nga tre gërma dhe 3 shifrat të kodit të regjistrimit dhe gjashtë shifrat e numrit të studentit në regjistrin përkatës. Formimi i numrit të matrikulimit është sipas shtojcës nr.1 bashkëlidhur këtij udhëzimi."

2. Pika 5 e udhëzimit ndryshon si më poshtë:

"5. Çdo regjistër të ketë një kod të vetin, unikal në sistemin e arsimit të lartë në Shqipëri, i përbërë nga tre gërma dhe tre shifra. Gërma e gjashtë e kodit të regjistrimit përcaktohet në bazë të ciklit të studimit dhe formës së studimit sipas shtojcës nr. 2 bashkëlidhur këtij udhëzimi."

Adresa: "Rruga e Durrësit"

Nr. 23, AL 1001, Tiranë

Tel: +355 4 222260, Fax : +355 4 2232002

Web site: www.mash.gov.al

3. Shtojcat nr. 2 dhe nr. 3 që i bashkëlidheshin Udhëzimit nr. 45, datë 19. 12. 2011 “Për gjenerimin dhe dhënien e numrave të matrikullimit” zëvendësohet me shtojcën nr. 2 dhe shtojcën nr. 3 që i bashkëlidhen këtij udhëzimi.
- II. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhëri Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Arsimit të Lartë dhe Kërkimit Shkencor, Drejtoria e Zhvillimit të Arsimit Privat, Agjencia Kombëtare e Provimeve dhe Institucionet e Arsimit të Lartë.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në “Fletoren zyrtare”.

MYQEREM TAFAJ

MINISTËR



Shtojca nr. 1 Formimi i numrit të matrikulimit

U	T	0	0	1	A	0	0	0	0	1	2
Universiteti		Programi i studimit			Tip. Regj	Nr. i Amzës					

Kodi i IAL përbëhet nga dy gërma të cilat vendosen në mënyrë unike.

Programi i studimit përbëhet nga tre gërma.

Tipi i Regjistrimit do të varet nga cikli dhe forma e studimit. Ai do të jetë i njehsuar për të gjitha IAL-të: një cikël studimi + një formë studimi do të përdorë të njëjtën gërmë.

Këto tre gërmat dhe tre shifrat përbëjnë kodin e regjistrimit dhe përcaktohen nga AKP.

Shtojca nr. 3: PASQYRA E STUDENTEVE TE REGJISTRUAR NE VITIN AKADEMIK 2011-2012
 Emërtimi sipas ciklit dhe formës së studimit (sipas shtojcës nr. 2)

Nr	Universiteti	Fakulteti	Cikli i studimit	Forma e studimit	Programi i studimit ¹⁾	Data e regjistrimit	Emri	Atësia	Mbiemri	Data lindja	Gjinia	Vendilindja	Numri personal i identitetit ²⁾	Lloji i Dokumentit të identitetit	Emri i shkollës së mesme/ universiteti nga vjen ³⁾	ID e matures ⁴⁾
1																
2																
3																
4																
5																
6																
7																
8																
9																
10																
11																
12																
13																
14																
15																

- 1) Të shënohet emërtimi zyrtar i miratuar për programin e studimit.
 - 2) Numri personal i identitetit në letërnjoftimin ID ose në pasaportën biometrike (ose dokument të barazvlefshëm me të për studentët e huaj).
 - 3) Të shënohet emri i shkollës së mesme ose universitetit me ciklin përkatës që studenti ka përfunduar dhe përdorur për tu regjistruar.
 - 4) ID e maturës nëse ka përfunduar shkollën e mesme pas vitit 2006 ose numri i amzës të dëftesës së shkollës së mesme përpara vitit 2006.
- Te Universiteti të shënohet emërtimi i plotë zyrtar i Institucionit.*
Te Fakulteti të shënohet emërtimi i plotë zyrtar i fakultetit që studenti ndjek.
Te cikli i studimit të shënohet emërtimi i plotë zyrtar.